



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 118, Datë 24.04.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/12 prot., datë 23.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka paraqitur aplikim për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në datën 26.02.2026.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 10.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.03.2026 dhe 12.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.03.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 275/6 prot., datë 12.03.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 275/7 prot., datë 19.03.2026 dhe nr. 275/9 prot., datë 08.04.2026, shoqëria ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion plotësues, duke kërkuar kohë për depozitim të dokumentacionit të mbetur.
- Për sa më sipër, me vendimin nr. 104, datë 14.04.2026, bordi vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencim në

veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 275/11 prot., datë 16.04.2026, shoqëria depozitoi dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Nga analizimi i aplikimit rezultoi se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e përcaktuar në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar.
- Duke qenë se shoqëria ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike deri më 23.06.2026, vlerësohet që afati 5-vjeçar të fillojë në datën 24.06.2026.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.06.2026.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GSA” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI